



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2023:256233  
Datë: 24.10.2024  
Numri i dokumentit: 06347950

P.nr.42/24

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË – DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM PENAL,** Gjyqtarja e vetme gjykuese Blerta Kelmendi, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Leonita Lajçi Muçaj, në çështjen penale ndaj të pandehurit L.D, nga fshati ..... i komunës së ....., për shkak të veprës penale “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve”, nga neni 366 par.1 si dhe veprën penale “Përdorim i armës apo mjetit të rrezikshëm” nga neni 367, par. 1 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës 04/L-082 (KPRK), sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë – Departamenti i Përgjithshëm PP/IL.NR.2183/23 të datës 12.01.2024, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimin fillestar publik të datës 08.10.2024, të mbajtur në prezencën e Prokurorit të shtetit Ermal Demhasaj nga Prokuroria Themelore në Pejë, të pandehurit L.D dhe mbrojtësit të tij av.Mustafë Kastrati, nga Peja, sipas autorizimit, me datën 10.10.2024, mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datën 24.10.2024, përpiloi këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I pandehuri:**

**L.D**, i lindur me datën ..... në ....., tani me banim në fshatin ....., në rr. “.....”, pa nr. Komuna e ....., nga i ati M. dhe e ëma L. e lindur ..... i pa martuar, ka të kryer shkollën fillore, me profesion punëtor, i gjendjes së mirë ekonomike, posedon numër telefoni ....., me nr. personal ID-..... Shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, mbrohet në liri.

**ËSHTË FAJTOR**

**Për shkak se:**

- I. Pasi më parë ka siguruar e gjerë me dt. 04.10.2023 rreth orës 19:33 në fshatin ..... Komuna ....., pikërisht të dyqanit ..... i pandehuri, në kundërshtim me ligjin e aplikueshëm për armët të Republikës së Kosovës Nr. 05/L-022, pa autorizim ka mbajtur në pronësi, kontroll dhe posedim të paautorizuar armën, e cila me ligj kategorizohen si armë zjarri të ndaluara, dhe atë Një (1) pistoletë të markës “Zastava” cal.7.62mm M57 me nr. serik 209898 e prodhimit Jugosllav, Një karikator, 5(pesë)fishek cal 7.62m për armën e njëjtë, në atë mënyrë që gjatë bisedës të pandehurit me zyrtarët policor të cilët paraprakisht i kanë ftuar për intervistim si

*të dyshuar për veprë penale nga neni 367, i pandehuri ka pranuar se me vete posedon armë, të cilën së bashku me karikatorin dhe fishekët i është konfiskuar nga ana e policisë,*

- Me çka ka kryer veprë penale **“Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve”** nga neni 366 parag.1 të KPRK-së.

II. *Me dt. 04.10.2023 rreth orës 19:33 në fshatin ....., Komuna ....., pikërisht të dyqanit ..... i pandehuri në kundërshtim me ligjin e aplikueshëm për armët të Republikës së Kosovës Nr. 05/L-022, me dashje përdor armën, pistoletë të markës “Zastava” cal.7.62mm M57 me nr. serik 209898 e prodhimit Jugosllavë, në atë mënyrë që mbrëmjen kritike i pandehuri kishte ftuar në takim të dëmtuarin A.B për ti sqaruar raportet që ka me nënën e ti, gjatë bisedës me të pasi i tregohen disa foto të nënës së tij së bashku me të dëmtuarin , pasi i dëmtuari pranon se është në lidhje me nënën e tij biseda mes tyre tensionohet, duke kërkuar të del nga automjeti, i pandehuri L. pasi ndihet i fyer nga kjo që i thotë i dëmtuari merr armën lartcekur të cilën e kishte në brez me të cilën gjuan një herë përpjetë në ajër dhe më pas largohet në drejtim të shtëpisë së tij.*

- Me çka ka kryer veprë penale **“Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm”** nga neni 367 parag.1 të KPRK-së.

Andaj, në aplikim të neneve 7, 8, 17, 38, 39 par.1 nën par. 1.1, neni 40 par. 1 pika 1.2, 43, 46 par.1 nënpar. 1.1, 47, 48, 49, 50, 53, neni 69, 70, 71, neni 366 par.1, neni 367 par.1, 366 par.3 të KPRK-së, si dhe nenit 358, 359, 361, 364, 365, 449 par. 1 dhe par. 2 pika 2.6 dhe 462 par.1 dhe 2 të KPRK-së, të pandehurit L.D:

## E G J Y K O N

- I. Për veprën penale **“Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve”** nga neni 366 par.1 të KPRK-së, nga pika I e dispozitivit të këtij aktgjykimi, i shqiptohet **DËNIMI ME GJOBË** në shumën prej gjashtëqind (600) euro, e të cilin dënim i njëjti obligohet ta paguajë në afat prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
- II. Për veprën penale **“Përdorim i armës apo mjetit të rrezikshëm”** nga neni 367 par.1 i KPRK-së, nga pika II e dispozitivit të këtij aktgjykimi, i shqiptohet **DËNIMI ME BURGIM** në kohëzgjatje prej një (1) viti, e i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri gjatë periudhës së verifikimit prej dy (2) vitesh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk kryen veprë tjetër penale.
- III. Nëse i pandehuri dënimin e shqiptuar në të holla dështon, refuzon apo nuk mund të paguajë dënimin me gjobë të përcaktuar si në pikën I të këtij dispozitivi të aktgjykimit, gjykata

në bazë të nenit 43 par. 3, të KPRK-së, do t'a zëvendësoj me dënim me burg, ku një (1) ditë burgim do të llogaritet me njëzetë (20) euro gjobë.

- IV.** Nëse i pandehuri gjatë periudhës së verifikimit kryen veprë tjetër penale, dënimi i kushtëzuar nga pika II të këtij dispozitivi do të revokohet dhe do të ekzekutohet dënimi me burgim.
- V.** Obligohet i akuzuari që të paguajë shpenzimet e procedurës penale dhe atë në emër të paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej tridhjetë (30) euro si dhe në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit të paguajë shumën prej njëzetë (20) euro, të gjitha këto në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit me dhunë.
- VI.** Në kuptim të nenin 366 par.3 dhe 367 par.3 të KPRK-së, konfiskohet arma e llojit Zastava e cal 7.62mm, M57, me nr.serik 209898, një karikator, 5 (pesë) fishek te cal.7.62 mm, të cilat pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi do të shkatërrohen.
- VII.** I dëmtuari A.B, nga fshati ....., i komunës së ....., për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt juridiko-civil.

### **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Pejë – Departamenti i Përgjithshëm, me datën 08.10.2024 ka ngritur aktakuzën kundër të pandehurit L.D nga ....., për shkak të dyshimit të bazuar se ka kryer veprën penale “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve”, nga neni 366 par.1 si dhe veprën penale “Përdorim i armës apo mjetit të rrezikshëm” nga neni 367 par. 1 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës 04/L-082 (KPRK).

Gjykata me datën 08.10.2024, ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar në këtë çështje penale, e konform dispozitës së nenit 240 të KPPRK-së, në të cilën kanë qenë prezentë Prokurori i shtetit Ermal Demhasaj nga Prokuroria Themelore në Pejë, i pandehuri L.D, mbrojtësi i tij av.Mustafë Kastrati i caktuar sipas autorizimit verbal te dhënë në këtë seancë, ndërkaq ka munguar i dëmtuari A.B, i cili për seancën ka qenë i njoftuar mirëpo nuk e ka arsyetuar mosardhjen.

Në këtë seancë, pasi që gjykata të pandehurit i ka komunikuar të drejtat dhe detyrimet që i takojnë në procedurën penale sipas KPPRK-së, i njëjti ka deklaruar së i ka kuptuar këto të drejta ndërsa për mbrojtës ka të autorizuar av.Mustafë Kastrati, nga Peja.

Pas leximit të aktakuzës nga ana e Prokurorit të Shtetit, gjykata e ka udhëzuar të pandehurin për kushtet, benefitet dhe pasojat e pranimit të fajësisë, dhe pasi që i pandehuri L.D, ka deklaruar se i ka kuptuar natyrën dhe pasojat e fajësisë gjykata, të njëjtit i ka dhënë mundësinë që të deklarohet për pranimin ose mos pranimin e fajësisë, me çrast i njëjti ka deklaruar se në mënyrë vullnetare dhe me vetëdije e pranon fajësinë, për veprat penale që i vihen në barrë, respektivisht për veprën

penale “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve”, nga neni 366 par. 1 si dhe veprën penale “Përdorim i armës apo mjetit të rrezikshëm” nga neni 367 par. 1 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës 04/L-082 (KPRK), ashtu siç ekziston në përmbajtje të aktakuzës pa asnjë ndryshim.

Lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, Prokurori i Shtetit ka deklaruar se: *pajtohem me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit. Po ashtu, edhe mbrojtësi i të pandehurit i cili deklaroj se: pajtohem me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, i njëjti është bere ne konsultim me mua, pas konsultimit me te pandehurin jam i bindur qe pranimi i fajësisë është ne favor te klientit tim andaj i propozoj gjykatës qe ta aprovoj pranimin e fajësisë.*

Në vijim, gjykata ka shqyrtuar pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit në raport me dispozitën ligjore të nenit 242 par. 2 nën par. 2.1, 2.2, 2.3 dhe 2.4 të KPPRK-së, dhe gjeti së në rastin konkret të gjitha këto kushte janë përmbushur në mënyrë kumulative.

Gjykata duke u gjendur para këtyre fakteve siç janë pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit si dhe duke pasur parasysh provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës siç janë: *Raporti i Oficerit G.K KPS11662 me nr. të rastit 2023-DA-1670 i dt. 04.10.2023; Raporti i Oficerit B.S KPS4736 me nr. të rastit 2023-DA-1670 i dt. 04.10.2023; Raport i këqyrjes së vendit të ngjarjes me nr të dosjes së forenzikës 597/23 për nr. të rastit 2023-DA-1670 i dt. 04.10.2023; Lista e dëshmimeve nga Njësia e Forenzikës me nr. të dosjes së forenzikës 597/23 për rastin me nr. 2023-DA-1670 i dt. 04.10.2023; Lista e dëshmimeve nga Njësia e Forenzikës me nr. të dosjes së forenzikës 607/23 për rastin me nr. 2023-DA-1670 i dt. 04.10.2023; Lista e armëve të konfiskuara me nr. të rastit 2023-DA-1670 i dt. 04.10.2023; Vërtetim mbi kthimin e dendeve të sekuestruara për kohësisht me nr. 2023-DA-1670 i dt. 04.10.2023; Raport Informues i policit hetues S. A.j #9994 me nr. të rastit 2023-DA-1670 i dt. 04.10.2023; Deklarata e të pandehurit L.D e dhëne në Stacionin Policor në Pejë me dt. 09.10.2023 si dhe në këtë prokurori me dt. 11.01.2024; Deklarata e të dëmtuarit A.B e dhënë në Stacionin Policor në Pejë me dt. 04.10.2023 si dhe në këtë prokurori me dt. 07.12.2023; Fotografitë nga vendi i ngjarjes, erdhi në përfundim se në veprimet e të pandehurit ekzistojnë të gjitha elementet e veprave penale të përshkruara si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.*

Pasi që palë njëzëri kanë deklaruar se nuk propozojnë që të caktohet seanca e posaçme me matjen e dënimit konform nenit 356 par.1 të KPPRK-së, pasi që nuk ka nevojë për në seancë të tillë, gjykata ka vazhduar seancën me shqiptimin e dënimit.

Prokurori i Shtetit lidhur me rrethanat lehtësuese dhe rënduese, ka deklaruar se: *si rrethana rënduese i propozoj gjykatës që të merr parasysh ndonjë dënim eventual të mëparshëm ndërsa si rrethanë lehtësuese pranimin e fajësisë.*

Mbrojtësi i të pandehurit av.Mustafë Kastrati, ka deklaruar se: *për të pandehurin tim nuk ka rrethana rënduese i lus gjykatës qe te merr parasysh pranimin e sinqerte të fajësisë, pendimin e sinqerte, moshën e tij juvenile, raportet e përmirësuar me te dëmtuarin, premtimin e sinqerte qe nuk do te përsërisë vepra te tilla dhe faktin qe deri me tani ska renë ndesh me ligjin. Gjykata*

*lutet qe te merr parasysh faktin se ky i akuzuar ne ketë moshë jeton me prindërit e divorcuar dhe nga jeta jo e rregullt e prindërve dhe mos kujdesi i tyre ndaj femiut e veçanërisht raporti i A.B me nenën e te akuzuarit e kane sjell te akuzuarin ne pozitën qe te reagoi emocionalisht.*

I pandehuri L.D, ka deklaruar se: *jam penduar për veprat penale qe kam kryer, i premtroj gjykatës qe ne te ardhmen nuk do te kryer vepra penale te tilla, te dëmtuarit A.B i kam kërkuar falje dhe raportet i kemi përmirësuar.*

Prandaj, me faktet e ofruara ne shkresat e lëndës, e po ashtu me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit është vërtetuar gjendja faktike si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Nga gjendja e vërtetuar faktike siç është përshkruar në dispozitiv të këtij aktgjykimit, rrjedh se në veprimet e të pandehurit, qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve”, nga neni 366 par.1 si dhe veprën penale “Përdorim i armës apo mjetit të rrezikshëm” nga neni 367 par. 1 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës 04/L-082 (KPRK).

Sa i përket fajësisë gjykata ka gjetur se të i pandehuri ka ekzistuar dashja që veprat penale ti kryej në mënyrë të përshkruar si në dispozitiv e I dhe II të këtij aktgjykimi, pasi që i pandehuri ka qenë i vetëdijshëm për veprimet e kryera dhe e ka dëshiruar kryerjen e tyre.

Gjatë procedurës penale nuk janë paraqit rrethana të cilat do ta zvogëlojnë apo përjashtojnë përgjegjësinë penale e të pandehurit, kështu që i njëjti është penalisht përgjegjës. Sa i përket fajësisë i pandehuri është i vetëdijshëm për veprën e kryer dhe gjykata e ka vërtetuar se e ka kryer me dashje.

Duke vendosur lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, Gjyqtarja e vetme gjykuese në pajtim me dispozitat ligjore të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së, i vlerësoi rrethanat lehtësuese dhe rënduese të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit ashtu që si rrethanë posaçërisht lehtësuese mori pranimin e fajësisë në shqyrtimin fillestar, pastaj si rrethanë lehtësuese mori faktin se të dëmtuarit i ka kërkuar falje, pendimin e tij për rastin e ndodhur, premtimin që në të ardhmen nuk do të kryej vepra të tilla apo të ngjashme penale, dhe që i njëjti nuk është i dënuar me parë, ndërsa si rrethanë rënduese gjykata mori në vlerësim rrezikshmërinë e këtyre veprave penale.

Andaj, gjykata duke u gjendur para këtyre rrethanave të akuzuarin e gjykoi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke konsideruar se ky dënim është në përputhje me shkallën e përgjegjësisë penale të tij dhe me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura të shoqërisë dhe është e bindur se vendimi mbi dënimin do të shërbej për arritjen e qëllimit të dënimit e që është pengimi i të akuzuarit në kryerjen e veprave penale në të ardhmen si dhe në preventivën tjetër për personat tjerë që të përmbahen nga kryerja e veprave penale konform nenit 38 të KPRK-së.

Vendimin mbi dënimin e përcaktuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për shqiptimin e dënimit me burgim të kushtëzuar sa i përket pikës së dytë të dispozitivit, gjykata e mori në kuptim të nenit 46, 47, 48, dhe 49 par.2 sipas të cilit “Dënimi me kusht mund t’i shqiptohet kryesisht të veprës penale për të cilën me ligj është paraparë dënimi me burgim deri në dhjetë (10) vjet, nëse

*zbatohen dispozitat e zbutjes së dënimit”, ndërkaq në par.4 përcaktohet se: “Me rastin e marrjes së vendimit për shqiptimin e dënimit me kusht, gjykata merr posaçërisht parasysh qëllimin e dënimit me kusht, sjelljen e mëparshme të kryesit, sjelljen e tij pas kryerjes së veprës penale, shkallën e përgjegjësisë penale dhe rrethanat e tjera në të cilat është kryer vepra penale”.*

Ndërkaq, sipas nenit 367 par.1 të KPRK-së, për veprën penale *“Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm”*, dënueshmëria e veprës penale është e paraparë që: *”Kushdo që përdorë armë apo materie plasëse në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm lidhur me armët apo materiet plasëse të tilla, dënohet me burgim prej një (1) deri në tetë (8) vjet”*, andaj gjykata vlerëson se dënimi me kusht i shqiptuar për këtë pikë të akuzës do të arrijë qëllimin e dënimit. Për më tepër gjykata vlerëson se tërheqja e vërejtjes së të pandehurit se nëse në periudhën verifikuese prej 2 vitesh do të kryej vepër tjetër penale ndaj tij do të ekzekutohet dënimi me burgim si në dispozitivin e këtij aktgjykimit, është një paralajmërim serioz ndaj të njëjtit që të parandalohet në kryerjen e veprave penale në të ardhmen.

Gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, sa i përket veprës penale *“Përdorim i armës apo mjetit të rrezikshëm”*, nga neni 71 par.1 nën par.1.3 të KPRK-së, i cili përcakton se Gjykata mund të shqiptojë dënim nën kufirin e paraparë me ligji apo të shqiptojë lloj me të butë të dënimit *“në rastet kur kryesi pranon fajësinë ose ka arritur marrëveshje për pranimin e fajësisë”*, pasi që i pandehuri e ka pranuar fajësinë në të gjitha fazat e procedurës penale, andaj mbi këtë fakt gjykata pranimin e fajësisë e mori si bazë për zbutjen e dënimit duke i shqiptuar dënim me kusht.

Andaj, duke u bazuar në të lartcekurat, gjykata në kuptim të nenit 366 par.1 dhe neni 367 par.1 e lidhur me nenin 43, 46, 47, 48, 49 të KPRK-së, i shqiptoi dënim të kushtëzuar me burgimi dhe dënim me gjobë si në pikën I dhe II të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Vendimi lidhur me revokimin e dënimit me kusht nëse i pandehuri kryen vepër tjetër penale brenda periudhës së verifikimit është marrë konform nenit 50 të KPRK-së.

Vendimi për zëvendësimin e dënimit me gjobë me dënim burgimi në rast se i pandehuri dështon, refuzon apo nuk mund të paguaj dënimin e shqiptuar me gjobë, është marrë konform nenit 43 par. 3 të KPRK-së.

Vendimi si në pikën e V të dispozitivit të këtij aktgjykimi lidhur me kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale dhe të paushallit gjyqësor, u morr në bazë të nenit 449 par.1 dhe 2, nën par. 2.1 dhe nën par. 2.6, të KPRK-së, ndërsa konform nenit 36 par.1, 2, 3 nën par. 3.1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit, gjykata të pandehurin e obligoi në pagesën e taksës për kompensimin e viktimave të krimit, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Duke u bazuar në dispozitat e nenit 366 par.3 dhe 367 par.3 të KPRK-së, arma Zastava e cal 7.62mm, M57, me nr.serik 209898, një karikator pesë (5) fishek të cal.7.62, të sekuestruara me datën 09.10.2023, sipas 2023-DA-1670, gjykata i konfiskojë dhe pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, është urdhëruar shkatërrimi i tyre.

I dëmtuari A.B, nga fshati ....., i komunës së....., për realizimin e kërkesës pasurore juridike, e në kuptim të nenit 462 par. 1 dhe 2 të KPPRK-së, udhëzohet në kontest të rregullt civil.

Nga sa u tha më lartë, e në kuptim të nenit 364 të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË**  
**DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM-DIVIZIONI PENAL**  
**P.nr.42/24, (2023:256233), me datë 24.10.2024.**

**Bashkëpunëtore profesionale**

**Gjyqtarja e vetme gjykuese**

---

**Leonita Lajqi Mucaj**

---

**Blerta KERMENDI**

**KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej tridhjetë (30) ditëve pas marrjes së aktgjykimit, në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate.